



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5572/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2021 merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.
2. Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 7 (shtatë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:
 1. Qamush Brava - AAK
 2. Nora Xhoni - AAK
 3. Teuta Shkreta - VV
 4. Sabedin Hasallari - LDK
 5. Mehmet Ballazhi - PDK
 6. Mefail Suma - NISMA
 7. Sead Vila - I PAVARUR
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e grupit punues,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.07.2021





01/Nr.4935/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2021 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar- Qershor 2021 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2021 është në shumë prej 2,520,165.91 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,684,502.11 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 810,386.79 € apo 49.10 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 157,735.16 € apo 44.66 %, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 25,274.42€ apo 37.72 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 33,885.00 € apo 42.20%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 154,053.92 € apo 32.19 % dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021 është në shumë prej 1,181,335.29 € apo 44.01 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 192,512.10 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Qershor 2021 apo 66.70% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje më shumë për 63,395.90 € apo 49.10%.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.07.2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4267 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , Ligji për Mjedis (2009/03-L-025) neni 24, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2021 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS 2021-2026

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për Planin Lokal për Veprim në Mjedis për vitin 2021 – 2026.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planin Lokal për Veprim në Mjedis për vitin 2021 – 2026.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.07.2021

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

